



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"

Nr. 715/1 Prot.

Tiranë, më 30.11.2022

Lwnda: Kthim Pwrgjigje

Në përgjigje të kërkesës Tuaj datë 23 Nëntor 2022 për informacion për ecurinë e sezoneve artistike të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli".

Ju bëjmë me dije se gjatë vitit 2021, për shkak të situatës së pandemisë aktiviteti i teatrit në sallë ka qenë i pezulluar. Pavarësisht kësaj në periudhën Janar – Qershor 2021 Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar kanë organizuar Festivalin Mbarëkombëtar i Teatrit Online "Moisiu on" me 20 shfaqje të transmetuara online. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është realizuar Festivali teatror studentor "E dua teatrin" me gjashtë shfaqje teatrore të transmetuara online.

Gjatë muajve Maj- Qershor 2021 me lejin e organizimit të aktiviteteve në ambientet e hapura është vijuar me programin e edukimit përmes artit duke luajtur për fëmijët e kopshteve dhe shkollave në oborrin e Arturbina shfaqjet e repertorit për fëmijë "Drejt imagjinatës" dhe "Hansel dhe Gretel" në një total prej 45 vëniesh.

Bordi Artistik i TKEKS është miratuar në 06 Tetor 2021 dhe shfaqjet teatrore në sallën e TKEKS kanë rifilluar në nëntor 2021. Bashkangjitur do të gjeni Vendimin e BA nr.2 datë 22/10/2022 për miratimin e projekteve artistike për periudhën Nëntor – Dhjetor 2021.

Bashkangjitur do të gjeni dhe Vendimet e Bordit Artistik për projektete artistike të realizuara përgjatë vitit 2022. Në këto vendime keni të pasqyruara edhe kostot financiare për secilin nga projektet e miratuara.

Ju bëjë me dije se përveç projekteve artistike të miratuara nga Bordi Artistik në skenën e TKEKS janë ngjitur edhe shfaqje nga skena e pavarur, teatrot e rretheve si dhe shfaqje nga Kosova me një total prej 37 shfaqjesh për vitin 2021 dhe 53 shfaqjesh për vitin 2022.

Gjatë vitit 2022 TKEKS ka realizuar marrëveshje me Univesitetin e Arteve dhe Universitetin e Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaja (të cialt i gjeni bashkangjitur). Janë shfaqur në skenën tonë shfaqjet e diplomës së studentëve të Artit skenik si dhe dy shfaqje nga studentët e FGJH. Trupa e TKEKS gjatë vitit 2020 ka pasur 10 pozicione aktorë dhe 10 aktorë të emëruar. Po ashtu gjatë vitit 2022 ka patur 10 pozicione aktorë dhe 10 aktorë të emëruar.

Numri i reprizave të realizuara për shfaqjet që keni kërkuar është si mëposhtë:

Makbeth – 10 shfaqje

Mefisto – 15 shfaqje

Të zhveshur por bashkë – 10 shfaqje

Pa zë – 10 shfaqje

Dita me e bukur – 14 shfaqje

Dhimbe e lehtë – 11 shfaqje

Çimka – 10 shfaqje

Kukulla – 15 shfaqje
Përvjetori i ditëlindjes – 15 shfaqje

Bashkngjitur po ju dërgojmë Vendimin e Bordit Artistik nr 2 datë 10/05/2022 për miratimin e projekteve fituese të Fondit të Teatrit për të rinjtë”.

Ju bëjmë më dije se nga 16 projektet e shpallura fituese janë realizuar 14 projekte pasi dy projekte, konkretisht “Tregtar flamujsh” me regjisor Fritz Selmani dhe “Pasaporta” me regji nga Ervis Saliasi janë tërhequr me kërkesë të vetë aplikantit për pamundësi realizimi.

Drejtore i Zhvillimit Artistik

Ada RUCI

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping, fluid strokes that form the name 'Ada Ruci'.